



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 17 shkronjat g) m), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 2 paragrafi 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr.03/L-049, neneve 14 dhe 19 paragrafët 1.7 dhe 1.13, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe nenit 6.22 të Rregullores për Taksa Tarifa dhe Gjoha Komunale nr.prot.01-431/04-0014941/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2021 miratoi këtë,

VENDIM PËR LIRIMIN NGA PAGESA E TAKSËS KOMUNALE

Neni 1

1. Me këtë vendim, lirohen nga pagesa e taksës komunale për vitin 2021:
- 1.1. Të gjitha subjektet afariste që ofrojnë shërbime të gastronomisë, për shfrytëzimin e hapësirës publike – tarracave pranë lokaleve të tyre.
 - 1.2. Të gjithë operatorët e transportit publik, përveç radio taksive.

Neni 2

Lirimi nga taksa sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të mbështetjes së subjekteve afariste dhe operatorëve ekonomik përkatëse për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia covid-19 dhe vështirësive financiare në ushtrimin e veprimtarive të tyre.

Neni 3

Zbatimin e Vendimit e bëjnë Drejtoritë komunale, varësisht fushveprimtarisë dhe kompetencave përkatëse.

Neni 4

Ky vendim ka efekt juridik nga data e hyrjes në fuqi deri më 31.12.2021.

Neni 5

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 parag. 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr.prot.01-350/03-0035821/21
Podujevë,
29 prill 2021

